



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: “FURNIZIMI ME AUTOAMBULANC PËR QMF-N NË MAMUSHË”

Numri i aktivitetit të prokurimit:

Nr2 i prokurimit	626-20-3193-1-2-1
Nr i brendshëm	626-20-019-1-2-1

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave €
1.	Jakup Siqani B.I. Brigadat e Rinisë, PRISHTINË	38,500.00
2.	LEDI MED SH.P.K. 28 Nëntori, SU 1/5,Nr.IV, PRISHTINË	38,850.00
3.		
4.		

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Komuna e Mamushës-Zyra e Prokurimit anulon aktivitetin e prokurimit me numër dhe titull të lartëcekur.

Data: 03.08.2020

Emri dhe mbiemri i ZPP: _____

Këshillë juridike: Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj janë shkelur nga vendimi i autoritetit kontraktues gjatë kryerjes së këtij aktiviteti të prokurimit, mund të bëjë kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e Autoritetit Kontraktues, përmes platformës elektronike.

¹ Ketij formulari bashkangjiten dhe letrat standard të njoftimeve: B42, B45 dhe B46. (shtoni letrat njoftuese sipas nevojës).

² Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Letër standarde për tenderuesin e eliminuar³

Mamushë më: 03.08.2020

Komuna e Mamushës- Zyra e Prokurimit Mamushë

Për: Operatorin Ekonomik- Jakup Siqani B.I. Brigadat e Rinisë, PRISHTINË

Nr4 i prokurimit	626-20-3193-1-2-1
Nr i brendshëm	626-20-019-1-2-1

Titulli: “FURNIZIMI ME AUTOAMBULANC PËR QMF-N NË MAMUSHË”

I nderuar Z. **Elod Siqani**

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

- ☐ Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara të cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;
- ☐ Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme të kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj;
- ☒ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe të kapacitetit teknik/profesional të saktësuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;

³ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt .

⁴ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

- ☐ Nuk e keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet [Formularin e paraqitjes së tenderit] [Formularin e paraqitjes së aplikacionit];
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- ☐ Nuk i keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- ☐ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;
- ☒ Nuk i keni përmbushur kërkesat formale/administrative
- ☒ Nuk i keni përmbushur kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale
- ☐ Nëse është e zbatueshme, kërkesa tjera formale/administrative.

[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik]-N/A

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Nuk e keni përmbushur nenin 5.3 të FTD të Dosjes së tenderi e cila ka përcaktuar se:

-Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që të hartojnë planin dinamik (Afatin e liferimit) në ditë sipas specifikimit teknik në aneksin 1 të kësaj dosje të tenderit

-Plani dinamik i hartuar (Afati i liferimit) nuk duhet të jetë më i gjatë se 40 (katërdhjetë) ditë nga data e porosis së mallit nga menaxheri i kontratës.

Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do të refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik.

Me datën 22.07.2020 kemi kërkuar sqarim në lidhje me specifikat teknike të ofruara nga ana juaj në katalogun e bashkangjitur të cilat nuk i janë përshtatur specifikave teknike të dosjes së tenderit, kemi kërkuar që të na dërgoni listën e projekteve të realizuara gjatë tri viteve të fundit si dhe kemi kërkuar që të na jepni sqarim në lidhje me pajisjet specifike mjekësore të cilat duhet të ketë autoambulanca. Ju me datën 24.07.2020 na keni kthyer përgjigje në lidhje me katalogun dhe disa specifika teknike por nuk na keni dhënë sqarime në lidhje me listën e projekteve të ngjashme të realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e njoftimit për kontratë si dhe nuk na keni dorëzuar katalogjet apo specifikat teknike të pajisjeve specifike mjekësore.

Edhe sa i përket specifikave teknike minimale të autoambulancës të kërkuara nga ana jonë disa nga specifikat e ofruara pas sqarimit nuk janë përputhur me specifikat teknike të kërkuara psh. Kapaciteti minimal i vëllimit të motorit, Shpenzimet mesatare të automjetit janë kërkuar që të jenë 5.3l/100km, ndërsa ju keni ofruar automjet me shpenzime mesatare prej 7.4l /100km.

Andaj, duke u bazuar në nenin 39.8 të rregullave dhe udhëzuesit të prokurimit në paraqitjen tabelore si dhe në nenin 28 të LPP-ës, tenderi juaj refuzohet si i papërgjegjshëm.

Lëshimet e cekura më lart kanë bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë.


Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Gazmend Gashi

(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)


(Nënshkrimi)



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Letër standarde për tenderuesin e eliminuar⁵

Mamushë më: 03.08.2020

Komuna e Mamushës- Zyra e Prokurimit Mamushë

Për: Operatorin Ekonomik- LEDI MED SH.P.K. 28 Nëntori, SU 1/5,Nr.IV, PRISHTINË

Nr. i Prokurimit:	626	1	9	3455	1	2	1
Nr.i brendshëm	626	1	9	018	1	2	1

Titulli: “Furnizimi me fshesa për pastrim dhe vegla pune”

I nderuar Z. **Arben Alushaj**

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

- ☐ Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara të cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;
- ☐ Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme të kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj;
- ☐ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe të kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- ☐ Nuk e keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet [Formularin e paraqitjes së tenderit] [Formularin e paraqitjes së aplikacionit];
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- ☐ Nuk i keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;

⁵ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt .

- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat formale/administrative
☒ Nuk i keni përmbushur kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale

☐ Nëse është e zbatueshme, kërkesa tjera formale/administrative.

[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik]-N/A

☐ Nën-kontraktuesi (t) juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.

[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Në dosjen e tenderit në nenin 9.1 & 9.2 të FTD-s Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, në pikën nr. 2 është paraqitur kërkesa si vijon:

2. Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin katalog te autoambulancës të cilën e ofrojnë.

Ndërsa si dëshmi është kërkuar:

2. Katalogun me specifika teknike të cilat i përshtaten specifikave teknike të kërkuara në aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Ju me tenderin tuaj keni dorëzuar një katalog në gjuhën Frënge i cili nuk ka ofruar specifikat teknike të detajuara sikur është kërkuar më lartë, andaj me datën 22.07.2020 kemi kërkuar sqarim në lidhje me specifikat teknike të ofruara nga ana juaj në katalogun e bashkangjitur, si dhe specifikat e pajisjeve speciale mjekësore dhe kemi kërkuar që katalogu të paraqitet në njërin nga gjuhët zyrtare në Kosovë për të vlerësuar në mënyrë të drejtë tenderin tuaj. Ju me datë 23.07.2020 na keni dërguar specifikat për pajisjet mjekësore si dhe një katalog në gjuhën angleze por që nuk ka ofruar specifikat e kërkuara në dosje të tenderit. Andaj me datë 28.07.2020 përmes platformës elektronike, kemi kërkuar disa sqarime shtesë për specifikat teknike të kërkuara në dosje të tenderit, ndërsa ju nuk jeni përgjigjur brenda afatit prej 2 ditëve dhe si pasojë, duke u bazuar në udhëzimin dhe rregullat e Prokurimit Publik, tenderi juaj është refuzuar si i pa përgjegjshëm.

Lëshimet e cekura më lart kanë bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë.


Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtrooni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Gazmend Gashi

(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)


(Nënshkrimi)



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Me 03.08.2020
M a m u s h ë

Referenca : 626/20/019/121

Në bazë të Nenit 60 paragrafi 1 pika 1.1 dhe Nenit 26 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Rregullores së Prokurimit nën 18 Paragrafi 2 pika 2.2 si menaxher i zyrës së prokurimit bie këtë :

V E N D I M

I

Anulohet aktiviteti i prokurimit me nr. 626/20/3193/121 dhe nr. të brendshëm 626/20/019/121

II

I njëjti duhet të rishpallet sipas procedurave të prokurimit pas afatit për ankesa.

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Mamushës, me datë 29.06.2020 ka shpallur njoftimin për kontratë me titull: **“FURNIZIMI ME AUTOAMBULANC PËR QMF-N NË MAMUSHË”** me nr. të prokurimit **626/20/3193/121** dhe nr. të brendshëm **626/20/019/121**. Dosjen e tenderit e kanë shkarkuar 15 (Pesëmbëdhjetë) Operatorë Ekonomik, ndërsa tenderin e kanë dorëzuar 2(dy) prej tyre. Pas vlerësimit të tenderit në fjalë, kemi konstatuar se të gjithë tenderët pjesëmarrës, kanë qenë të pa përgjegjshëm sepse nuk i kanë plotësuar kërkesat e paraqitura në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Andaj duke u bazuar në atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gazmend Gashi
Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës

